

## **NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarve L.K. nga fsh. ..., Komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par. 1 nën par. 5 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, ndërsa, për të akuzuarit G.I., D.A. dhe S.N., te tre nga Prishtina, për shkak të veprës penale moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale në bashkëkryerje nga neni 385 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, përgjigje në ankesat e të akuzuarit G.I., av. R.D., dhe mbrojtësit të akuzuarit L.K., av. N.S., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore – DKR në Prishtinë, PKR.nr.338/2015, të dt. 09.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK, me datë 24.08.2018, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.nr.338/2015, të dt. 09.03.2018, vërtetohet.

## **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore - DKR në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.338/2015, të dt. 09.03.2018, të akuzuarve L.K., G.I., D.A. dhe S.N., bazuar në dispozitat e nenit 364 par. 1 nën par. 3 të KPPK, i ka liruar të akuzuarit: dhe atë të akuzuarin L.K., për veprat penale, vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par. 1 nën par. 5 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, ndërsa, të akuzuarit G.I., D.A. dhe S.N., për veprën penale moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale në bashkëkryerje nga neni 385 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me arsyetim se nga provat e proceduara në shqyrtim gjyqësor, nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Për shpenzimet e procedurës penale është vendosur që të mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari Q.S., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore - DKR në Prishtinë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesën e prokurorisë kanë paraqitur mbrojtësit e të akuzuarve L.K. dhe G.I., av. N.S. dhe av. R.D., të cilët kanë propozuar që ankesa e Prokurorisë të refuzohet si e pabazuar, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e caktoi konform dispozitës, së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën nuk janë njoftuar fare palët, pasi që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me aktgjykim, ku është shqiptuar dënimi me burgim prandaj, njoftimi i palëve nuk është i obligueshëm.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/I.nr.294/2018, të datës 27.06.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë, të anulohet, ndërsa, çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar, në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë dhe përgjigje te ankesës, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Me ankesën e paraqitur aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë, Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë drejtim, duke vepruar kështu konform dispozitave të nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimin në fjalë.

Me ankesën e Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, përkitazi me bazën ankimore vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, kontestohet mënyra se si janë vlerësuar provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë, e duke pretenduar kështu se edhe konkludimet e asaj gjykate të nxjerra në bazë të këtyre provave janë të gabuara. Pretendohet se provat në fjalë janë vlerësuar në mënyrë të njëanshme dhe të gabuara dhe se si pasojë e vlerësimit në fjalë edhe konkludimet e aprovuara kanë rezultuar me shkelje të ligjit Penal në favor të akuzuarve, për çka gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka vepruar, sidomos kur vendimin e ka marrë, duke mos marrë parasysh faktet dhe rrethanat e vërtetuara nga deklaratat e dëshmitarëve, gjegjësisht të dëmtuarve por edhe provat materiale, ku rezulton gjendja faktike e konstatuar si në dispozitiv të aktakuzës, gjendje kjo faktike nga e cila plotësohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën të akuzuarit janë akuzuar me aktakuzë, mirëpo edhe përkundër gjendjes faktike të vërtetuar gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit i ka liruar nga akuza për veprat penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par. 1 nën par. 5 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, të akuzuarin L.K., ndërsa, të akuzuarit G.I., D.A. dhe S.N., për veprën penale moslajmërimi i përgatitjes së veprës

penale në bashkëkryerje nga neni 385 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Gjithashtu, gjithherë sipas pretendimeve ankimore, me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor e sidomos deklaratat e dëshmitarëve – të dëmtuarve R.B. dhe Q.S., deklaratat këto të cilat, si ato të dhëna në polici edhe në prokurori, vërtetohet gjendja faktike e përshkruar më detajisht si në dispozitiv të aktakuzës. Gjithherë sipas pretendimeve ankimore, i dëmtuari R.B. në mënyrë të qartë dhe më në detaje ka deklaruar se të akuzuarin L.K., edhe pse nuk e ka njohur më parë, të njëjtin e ka vërejtur mirë kur ditën kritike nga pjesa e pasme e automjetit ka shtënë me armë zjarri në drejtim të automjetit të dëmtuarit, fakte këto dhe rrethana që i ka vërtetuar edhe i dëmtuari tjetër – dëshmitari Q.S., i cili ka deklaruar se pasi që ditën kritike me veturën në të cilën ka qëndruar ka qenë shumë afër personave që kanë qëlluar me armë ka arritur që t'ua shohë fytyrat dhe se personi që ka qenë i ulur afër shoferit ia ka identifikuar fytyrën dhe përmes internetit e ka identifikuar të akuzuarin S.N., mirëpo, të njëjtin nuk e ka parë asnjëherë më parë, por, nga pamja në fjalë e ka identifikuar edhe të akuzuarin Leotrim, pastaj, vozitësin e automjetit – pra, të akuzuarit ... dhe personin e katërt G.I., me të cilin i akuzuari i parë R.B. ka pasur probleme edhe më herët, prandaj, duke marrë parasysh faktet dhe rrethanat e cekura më lartë, pa mëdyshje rezultoi se i akuzuari L.K., është dashur që të shpallet fajtor për veprën penale dhunimi në bashkëkryerje në tentative nga neni 193 par. 1 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së, ndërsa, të akuzuarit G.I., D.A. dhe S.N. për veprën penale moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale në bashkëkryerje nga neni 385 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për çka, gjykata e shkallës së parë, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal, kuptohet, në favor të akuzuarve kur të njëjtit i ka liruar nga akuza e prokurorisë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të cekura si më lartë, nuk qëndrojnë, ngase, gjykata e shkallës së parë, provat e proceduara i ka vlerësuar në përputhje me dispozitat e nenit 361 të KPPK-së, kështu që drejtë i ka vlerësuar dhe analizuar faktet vendimtare, përkritazi me këtë çështje penale–juridike dhe në mënyrë të pa dyshimtë ka vërtetuar gjendjen faktike në bazë të së cilës edhe i ka liruar të akuzuarit nga akuza, për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par. 1 nën par. 5 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, të akuzuarin L.K., ndërsa të akuzuarit G.I., D.A. dhe S.N., për veprën penale moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale në bashkëkryerje nga neni 385 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Në rastin konkret me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor në mënyrë të pa kontestuar gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se ditën kritike, pra më datën 07.03.2015, rreth orës 20,00 min. në Rr. “27 Nëntori” në Prishtinë, në momentin kur po kalonin me automjetin e tyre të makrës “Golf 2” të dëmtuarit R.B. dhe Q.S., aty pari ka kaluar automjeti tjetër i markës “Mercedes”, me ngjyrë të zezë si dhe dritare të errësuar, ku nga pjesa e prapme e automjetit në fjalë, nga persona të panjohur – të paidentifikuar është shtënë me armë zjarri dhe atë të markës “AK 47”, në drejtim të automjetit “Golf 2”, ku nga të shtënat në fjalë janë qëlluar dy gomat e pasme të automjetit si dhe xhamat e dyerve të para, për çka, pastaj, të dëmtuarit ndalojnë automjetin, ndërsa, persona të panjohur me automjetin e markës “Mercedes”, largohet nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur dhe të dëmtuarit nuk arrijnë të identifikojnë tabelat e regjistrimit, por as personat që kanë qenë në automjet, për çka, pastaj, kanë thirrë për ndihmë policin, e cila menjëherë ka ardhur në vendin e ngjarjes dhe në deklaratat e para të marra nga të dëmtuarit – dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes, kanë deklaruar se janë sulmuar nga disa persona të panjohur që kanë qenë në automjetin e markës “Mercedes”, të ngjyrës së zezë, por, personat në fjalë sikur edhe tabelat e regjistrimit nuk kanë arritur t'i identifikojnë. Faktet dhe rrethanat në fjalë, pra, të konstatuara si më lartë, gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe përmes deklaratave të dëmtuarve – dëshmitarëve okular në vendin e

ngjarjes, R.B. dhe Q.S., pastaj, edhe provat materiale në shkresa të lëndës, por që nuk i kontestojnë as vetë të akuzuarit L.K., G.I., D.A. dhe S.N..

Ndërsa, përkitazi me faktet kontestuese se kush ishin personat që kanë shtënë me armë zjarri në drejtim të dëmtuarve R.B. dhe Q.S., gjykata e shkallës së parë, përveç deklaratave të akuzuarve, të cilët e mohojnë kryerjen e veprës penale duke u arsyetuar se natën kritike nuk kanë qenë fare në vendin e ngjarjes, ka marrë parasysh së pari deklaratën e të dëmtuarit-dëshmitarit R.B., dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes, i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se natën kritike nuk i ka njohur personat që kanë shtënë në drejtim të tij, për çka edhe në polici nuk ka deklaruar asgjë përkitazi me të akuzuarit, pastaj, as në prokurori, mirëpo, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se i ka njohur personat që kanë shtënë në të, pra, L.K.n, të cilin e ka identifikuar përmes internetit – Fcb, dhe atë duke krahasuar pamjen e tij që e ka parë ditën kritike me pamjet që ka shikuar në Fcb, duke hulumtuar në internet – Fcb, ku arrin ta identifikojë personin që ka shtënë ditën kritike në të dëmtuarin. Sipas deklaratave të dëshmitarëve në fjalë, edhe persona të tjerë, po ashtu, përmes internetit – Fcb, i ka identifikuar dhe atë duke gjurmuar së pari, në llogarinë e të akuzuarit G.I., të cilin e ka njohur më parë, ngase, me të njëjtin ka pasur një konflikt më herët, gjegjësisht të njëjtën ka plaguar me armë zjarri gjatë një konflikti me disa persona të tjerë gjatë vitit 2013, prandaj, pasi ka dyshuar në të akuzuarin G.I., përmes llogarisë së tij në Fcb, ka zbuluar edhe të akuzuarit tjerë të cilët nuk i ka njohur ditën kritike por pasi që të njëjtit kanë komunikuar përmes Fcb me të akuzuarin G.I., dhe po ashtu, gjatë komunikimit kanë bërë edhe komentimin e ngjarjes ditën kritike, dhe atë edhe duke ofenduar përkitazi me ngjarjen e ditës kritike, për çka ka ardhur në përfundim se të akuzuarit L.K., D.A. dhe S.N., kanë qenë së bashku me të akuzuarin G.I., për çka, pastaj, edhe ka konsideruar se pikërisht të akuzuarit janë personat që kanë shtënë natën kritike në automjetin “Golf 2”. Përkitazi me faktet kontestuese, fakte dhe rrethana pothuajse të njëjta i deklaroi edhe i dëmtuarit – dëshmitari tjetër Q.S., i cili deklaroi se ditën kritike nuk i ka njohur personat që kanë qenë në automjetin e markës “Mercedes” mirëpo, më vonë përmes hulumtimeve që ka bërë në internet – Fcb, e duke marrë parasysh pamjet e personave në fjalë nga dita kritike e pasi të njëjtit pastaj i identifikoi përmes fotove të tyre në Fcb, e duke konsideruar kështu se personat në fjalë, ditën kritike kanë qenë të akuzuarit L.K., G.I., D.A. dhe S.N., pra, edhe ky i akuzuar, në mënyrë të njëjtë sikurse i akuzuari i parë, konstaton se ditën kritike kanë qenë pikërisht të akuzuarit persona që kanë shtënë në automjetin “Golf 2”.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë, gjegjësisht faktet jo kontestuese se natën kritike, persona të armatosur dhe të paidentifikuar me automjetin e markës “Mercedes” me ngjyrë të zezë, ua kanë nxënë rrugën më parë të dëmtuarve, të cilët po kalonin aty pari me automjetin e tyre të markës “Golf 2” dhe pastaj, pasi njëri nga personat në fjalë ka shtënë me armë zjarri në drejtim të automjetit të markës “Golf 2”, dhe pastaj janë larguar nga vendi i ngjarjes, kurse të dëmtuarit të cilët gjendeshin në automjetin e markës “Golf 2”, për shkak të orëve të vona të mbrëmjes, pra, ishte errësirë, nuk kanë arritur që t’i identifikojnë personat e panjohur, por as tabelat e regjistrimit të automjetit, mirëpo, në ndërkohë i dëmtuari R.B. përmes internetit – Fcb, duke u futur në llogarinë e Fcb të akuzuarit G.I., në të cilin ka dyshuar se ka qenë natën kritike për shkak se të njëjtin disa vite më parë e ka plagosur duke gjuajtur me armë zjarri edhe në disa persona tjerë, ka gjetur komunikimet e të akuzuarit në fjalë, me tre të akuzuarit tjerë, dhe atë duke komunikuar ngjarjen që ka ndodhur natën kritike, pra, më datën 07.03.2015, dhe atë duke bërë shaka njëri me tjetrin përkitazi me këtë ngjarje, për çka pastaj edhe ka dyshuar se pikërisht personat në fjalë kanë qenë natën kritike, atëherë, me të drejtë gjykata e shkallës së parë, deklaratave në fjalë nuk ua ka falur besimin, duke konkluduar kështu, se të njëjtat janë vetëm supozime dhe paragjykime, ngase, duke pasur parasysh kohën e kryerjes së veprës penale-pra, kur ka qenë errësirë, të dëmtuarit nuk

kanë mundur t'i shohin personat e dyshuar dhe as t'i identifikojnë, atëherë nuk ka pasur mundësi që të njëjtit të identifikohen përmes Fcb, sikur që kanë deklaruar të dëmtuarit, prandaj, nuk mund të vërtetohet se ditën kritike pikërisht të akuzuarit kanë qenë personat që kanë kryer veprat penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par. 1 nën par. 5 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, ndërsa, për të akuzuarit G.I., D.A. dhe S.N., te tre nga Prishtina, për shkak të veprës penale moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale në bashkëkryerje nga neni 385 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për çka, kjo gjykatë konstaton se konkludimet e gjykatës së shkallës së parë, janë të drejta dhe të logjikshme që do të thotë se drejtë është aplikuar edhe Ligji Penal dhe nuk ka shkelje të Ligjit Penal, në favor të akuzuarve, sikur që pretendohet në ankesë.

Prandaj, duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, kjo gjykatë vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par. 1 nën par. 5 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, për të akuzuarin L.K., ndërsa, për të akuzuarit G.I., D.A. dhe S.N., për shkak të veprës penale moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale në bashkëkryerje nga neni 385 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së ngase, me asnjë provë nuk është vërtetuar se kanë qenë pikërisht të akuzuarit natën kritike, prandaj, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore, se të akuzuarit është dashur të shpallen fajtor për këtë vepër penale, qartazi janë të pa bazuara e pa mbështetje në prova, apo në shkresa tjera të lëndës.

Nga çka u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.313/2018, të dt. 24.08.2018**

**Procesmbajtësi,**  
**Eroll Gashi**

**Anëtarët e kolegjit,**  
**1.Xhevdet Abazi**

**Kryetar i kolegjit,**  
**Abdullah Ahmeti**

\_\_\_\_\_  
**2.Afrim Shala**  
\_\_\_\_\_